



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 8, Datë 10.01.2018

MBI

**MIRATIMIN E LICENCËS TIP TË AKTIVITETIT TË TRANSMETIMIT TË GAZIT
NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe neneve 22; 23 dhe 35 të Ligjit nr. 102 /2015 “Mbi Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për miratimin e Licencës tip të Transmetimit të Gazit Natyror, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE,

Kostatoi se:

- Me vendimin nr. 153, datë 28.09.2017, ERE ka filluar procedura për miratimin e Licencës Tip të Transmetimit të Gazit Natyror.
- Me shkresën nr.100/46 Prot., datë 02.10.2017, ERE ka vijuar me publikimin në media të njoftimit për fillimin e procedurës për miratimin e licencës Tip të Transmetimit të Gazit Natyror.
- Me shkresën nr. 166/8 Prot., datë 03.10.2017, ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Albgaz sh.a, Albpetrol sh.a. edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
- Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët rezultoi se mbi këtë draft-licencë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, komentet e të cilave janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë Licencën Tip të aktivitetit të Transmetimit të Gazit Natyror.
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

https://ere.gov.al/doc/LICENCA_E_TRANSMETIMIT_GAZ_FIN-1.pdf